

DISA MËNYRA TË PËRLIGJJES TË SË DREJTAVE NË SHTETIN LIGJOR: PARADIGMA E HABERMASIT

Adriana ANXHAKU*

Abstrakt: Mënyra e përlicjjes së të drejtave në një shtet ligjor demokratik ka ndryshuar me kalimin e kohës, për shkak edhe të ndryshimit të funksioneve që ka pasur më herët ky shtet dhe të detyrave të tjera që ka marrë përsipër ai ndërkohë. Në diskutimin e mënyrës më të mirë të përlicjjes të së drejtës janë përfshirë një grup studiuesish bashkëkohorë, të cilët kanë marrë parasysh rrethanat e reja dhe nevojën që ligji të qaset sa më tepër me zbatuesit e tij. Kjo sepse parimi i pjesëmarrjes në demokraci i ngre zbatuesit e ligjit në nivelin e qenieve të përgjegjshme, por dhe të afta për të marrë pjesë në përmirësimin ose kritikën e ligjeve. Një ndër këta studiues, që parashtron disa paradigma mundshme të përlicjjes është Jyrgen Habermasi. Paradigmat e tij mund të jenë me interes për zbatime konkrete në fushën e të drejtës, gjë që ka ndodhur edhe më parë me këtë autor, ndikimi i të cilit mund të duket sidomos në diskutimet e ndryshme për ligjet të Bundestagut gjerman e jashtë tij. Ndryshe prej Hegelit që shpreson të vërë në punë pjesën e arsyeshme të institucioneve, Habermasi propozon një rrugë tjetër për të përlicjur apo edhe kritikuar të drejtën: Të njohë e të paraqesë sa më shumë pjesën e paarsyeshme të institucioneve, në mënyrë që të mbrojë shoqërinë prej ngërçit të tyre. Fillimisht në artikull më duhet të vë në dukje disa ndryshime kryesore që ka pësuar shteti ligjor në funksionet e tij. Këto ndryshime e kanë bërë domosdoshme rishikimin e mënyrave të përlicjjes së ligjeve pozitive. Pastaj më duhet të shqyrtoj format tradicionale të përlicjjes të së drejtës, në mënyrë që parashtroj ato paradigma që sjell Habermasi si të reja, duke i vlerësuar në mënyrë kritike ato.

Fjalët kyç: Argumentim, diskutim, konsensus, legjitimitet, parime morale.

1. Ndryshime në funksionet e shtetit ligjor

Kritika kryesore që i bëhet sot shtetit të së drejtës është se ai nuk merr parasysh lidhjen e ligjit parlamentar me pasojat e tij në jetën e përditshme. Domethënë, mjaft ligje që mund të duken shumë të mira nga ana formale nuk përputhen me realitetin dhe nuk gjejnë zbatimin e duhur. Krahas faktorëve të tjerë që mund të ndikojnë në këtë dukuri, mënyra e përlicjjes së tyre është një tregues i faktit, nëse ligjet janë në përputhje me interesat e sa më shumë qytetarëve të mundshëm. Gjithashtu, mungesa e përlicjjes së duhur e çon në krizë shpërndarjen e pushteteve, siç po e shohim rëndom në jetën e përditshme.

Dr. Adriana Anxhaku, Departamenti i Filozofisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Praktika e sotme moderne na paraqet një shkallë të lartë ndërlikueshmërie të shtetit ligjor, një vartësi nga situatat dhe pasiguri, gjë që duket në faktin se shumë dukuri jo vetëm natyrore, por shoqërore me pasoja të rënda për komunitetin, nuk mund të parashikohen në mënyrë normative nga ligji. Të tilla mund të jenë kriza ekonomike, luftra rajonale etj. Kjo ka sjellë si pasojë që para shteteve ligjore të shtrohen detyra të reja cilësore. Konkretisht, shteti aktual ka kaluar nga detyrat e administrimit klasik të vendosjes së rendit në një shoqëri me peshë kryesore ekonomike. Kështu që detyrat e tij në drejtim të rendit erdhën duke u pakësuar, edhe për shkak të konkurrencës së lirë. Kemi pra kalimin nga një shoqëri në të cilën theksi bie mbi sigurinë e të drejtave në një shoqëri ku theksi bie në sigurimin e të mirave materiale të drejta.

Më parë, ligji abstrakt që paraqitet në të drejtën kushtetuese ishte i lidhur me fakte konkrete tipike dhe pasojat e së drejtës ishin të njëkuptimta, sepse synimi i tyre i përbashkët ishte garantimi i lirive të qytetarëve. Por kur në një shtet social, administrimit sipas ligjvënësve iu shtuan edhe detyrat e drejtimit politik, ligji në formën e tij klasike nuk mjaftonte më për të programuar praktikën e administrimit. Arritja e synimeve të tilla, si përkujdesi për qenien njerëzore, rregullimi i infrastrukturës, planifikimi dhe mënjanimi i rreziqeve, janë detyra relativisht të reja politike që ka marrë përsipër shteti social. Ndërhyrjet e tij gjithashtu, vazhdojnë të rregullojnë lidhjet ndërmjet qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Kësisoj praktika e sotme moderne na paraqet atë shkallë të lartë ndërlikueshmërie e pasigurie në të drejta që përmendëm më sipër. Duke mos qenë e mundur ndërhyrja e parashikimi i pasojave të shumë dukurive, është shtuar numri i ligjeve që mund të përmbliidhen nën tematikën, "marrje e masave për". Janë shtuar gjithashtu ligjet e përkohshme dhe eksperimentuese, si dhe ligjet orientuese. Shtimi i ligjeve të vagullta dhe i klauzolave të përgjithshme në gjuhën e ligjvënësit e ka çliruar disi të drejtën nga frika që karakterizon jurisprudencën amerikane ose atë gjermane për zbatueshmëri të përpiktë.

Këto ndryshime sjellin edhe një sërë pasojash në shpërndarjen më funksionale të pushteteve, sepse administrata bëhet e paaftë, duke marrë të mirëqenë se e ka kualifikimin e duhur, për të ndërhyrë apo për të përdorur ligjin. Dhe aty ku ajo mund të ndërhyjë, nuk ka asnjë elasticitet apo rezervë për përdorimin e ligjit, por ligji merret i ngurtë. Prandaj Habermasi mendon se nuk ka lidhje të ligjeve me jetën faktike e as kontroll të zbatimit të tyre deri në gjykata. Kjo mangësi shfaqet në faktin se ligjet e Humbasin efektin e tyre mbrojtës deri dhe të të drejtave bazë. Në këtë rast, administrata mund të propozonte sjelljen sipas disa klauzolave që nuk bien ndesh me parimet e së drejtës.

Gjithashtu, shteti po ndeshet me rreziqe të ndryshme që vijnë tashmë edhe nga zhvillimet në fushat tekniko-shkencore, si për shembull përdorimi i energjisë bërthamore ose

teknika e gjeneve. Kjo e ka vendosur atë përballë çështjes së kujdesit për brezat e ardhshëm. Kjo situatë ka kërkuar edhe nga ligjvënësit një zgjerim të perspektivave dhe të interesave që përfaqësojnë. Prandaj shteti i sotëm në funksionimin e tij duhet të zgjidhë një mal problemesh që kanë të bëjnë me lidhjen e ligjeve me realitetin dhe zbatimin e së drejtës. Nga njëra anë bëhet e pamundur aftësia parashikuese e ligjvënësve, për shkak të kësaj ndërlikueshmërie, sepse programet e veprimit sot në shoqëri mund të rregullohen vetëm pjesërisht me norma, nga ana tjetër ulet aftësia drejtuese e shtetit dhe veprimi i tij për të parandaluar rreziqet dhe grupet me rrezik më të madh në shoqëri.

2. Përligjja tradicionale legale dhe problemet e saj

Legaliteti këtu kuptohet si një shprehje e një racionaliteti të caktuar që mishërohet në disa cilësi të së drejtës moderne si krijimi i ligjeve sipas një përvoje të parashikuar, dallimi ndërmjet faktit dhe përvojave personale për të, si dhe zbatimin e së drejtës duke marrë si arbitër ekspertët e saj, në procedurat që ndiqen për zgjidhjen e çështjeve të diskutueshme. Sipas Weberit, një racionalitet i tillë formal luan rolin e një përligjje. E drejta pozitive mund të përligjet pra nëpërmjet legalitetit të saj profesional. Weberi kishte parasysh racionalitetin burokratik të së drejtës formale, dhe atëherë shteti nuk ishte aq i ndërlikuar në detyrat që kishte marrë përsipër për të zgjidhur sa sot.

Problemi i mjaft sistemeve edhe me demokraci të konsoliduar aktualisht është se ata e shohin të drejtën të instrumentalizuar, domethënë, si një mjet ndër të tjerë për të arritur qëllime politike të ngushta. Në një kohë që parimet e së drejtës vënë kushtet për veprimin e politikës. Niklas Luhman, një tjetër studiues i kësaj fushe, pretendon se e drejta është një sistem i pavarur që qëndron krahas sistemeve të tjera si politika, ekonomia etj. Pra e drejta, sipas tij, nuk i merr rregullat e veta nga morali por nga vetja (autopietik). Sistemet e tjera i shërbejnë vetëm si mjedis së drejtës, domethënë mund të ushtrojnë ndikim në të vetëm po qe se pranohen prej saj. Për shembull, se si do të reagojë e drejta ndaj ndryshimeve në moral dhe në ekonomi varet prej saj dhe jo nga masat që marrin ligjvënësit. Këtë ide Habermasi e përdor pjesërisht kur pohon se e drejta nuk duhet të jetë nën urdhrat e politikës, sepse kështu ka më shumë mundësi të humbasë jo vetëm legalitetin e saj por edhe përligjjen duke u përdorur nga një grup personash partiakë, për qëllime të ngushta përfituese në kurriz të të tjerëve.

Në fakt kjo frikë e Habermasit zë fill qysh te Rusoi kur flet për "vullnetin e përgjithshëm" dhe "vullnetin e të gjithëve" (partitë). Ideja e tij është pikërisht e drejta si një produkt i arsyeshem dhe me ndikim të përbashkët të qytetarëve. Ky vullnet i përgjithshëm duhet t'i shoshitë dhe të ndajë interesat e veçanta, të arsyeshme ose jo të qytetarëve. Sindroma e përfaqësimit të ngushtë të së drejtës shfaqet në demokraci, kur një shtresë burokratike që shpreh interesat e një grupi të kufizuar qytetarësh, tregtarësh ose sipërmarrës si në kohën e Weberit ose dhe të tjerë, bën ligje në përputhje me interesat e

veta dhe në kurriz të qytetarëve të tjerë, nëpërmjet ligjvënësve. Kësisoj, mënyra e legale e përligjjes të së drejtës në një shtet demokratik që pretendon të përfaqësojë qytetarët, na tregon se rreziku është gjithnjë i pranishëm. Prandaj, Habermasi paralajmëron:

Kushtetutshmëria e të drejtave mund të vihet në dyshim në rast se politika e përdor formën e së drejtës për të arritur qëllime politike të çfarëdoshme, duke shkatërruar funksionin vetjak të së drejtës”. (Habermas, 2002: 517)

Një e drejtë që nuk i bën rezistencë ligjvënësve bëhet identike me politikën në një kohë që është sistem i pavarur, dhe medium i përgjithshëm i shoqërisë. Prandaj, pavarësia e sistemit është e shenjtë. Natyrisht se, me ndryshimin e programeve politike të ligjvënësve ndryshojnë me siguri edhe përmbajtjet konkrete të së drejtës. Por, nevoja për normimin e pritshmërisë së sjelljeve e nxit politikën përtej caqeve të saj në përpjekje për ta vënë nën kontroll të gjithë të drejtën dhe për ta bërë lodër të saj. Në rastin kur burimi i vetëm i së drejtës bëhet politika, ka shumë të ngjarë që të kemi një hendek gjithnjë e më të madh, të realitetit faktik nga ligjet që miratohen. Dhe meqenëse veprimet e njerëzve janë shumë më të larmishme se ato që parashikon ligji, qytetarët do ta shohin ligjin vetëm si një forcë shtrënguese e jashtme, të cilës do përpiqen t’i ikin me çdo kusht.

Habermasi tërheq vëmendjen se problemet e legjitimitetit të së drejtës nuk mund të reduktohen në pazotësinë e atyre që drejtojnë shtetin, prandaj ai shkruan: “Kush i sheh problemet e përligjjes të së drejtës, të varura vetëm nga problemet e drejtuesve të pushtetit, nisat nga një premisë e gabuar. Mungesa e përligjjes shpesh vjen prej problemeve në gjenezën demokratike të së drejtës, gjë që çon në probleme të pazgjidhura të drejtimit të shtetit.” (Habermas, 2002:518)

Kjo gjenezë e së drejtës ka anën *objektive* ose legale që përmbledhet në faktin se, e drejta duhet të sjellë një rend funksional të jashtëm, ka edhe anën *subjektive*, që është, se kjo e drejtë shërben si kufiri i veprimit të lirë të subjektit, në kuptimin se individit duhet të llogarisë për të realizuar qëllimet e tij nëpërmjet saj në mënyrë optimale. Në këtë mënyrë, si shprehje e vetëpërcaktimit, domethënë si shprehje jo e një arsyeje të huaj por të një arsyeje vetjake, e drejta nuk është një kufi por një hapësirë e shpalosjes së lirë të individit. Aty ku mungon ky vlerësim, e drejta shihet jo vetëm si diçka e huaj për qytetarin por edhe si një pengesë për planet e tij vepruese. E drejta duhet të jetë, - sipas Habermasit, - jo vetëm e pranueshme por dhe e brendshme për njeriun” (Habermas, 2002:227). Kjo kërkesë bazë, e cila kushtëzon legalitetin në përmbajtje është që, njerëzit duhet të binden pa dhunë, me arsye se ajo çfarë parashtron ligji është e drejtë, përndryshe ai nuk zbatohet siç duhet, ose nuk zbatohet fare. Ndërsa, koncepti i përfaqësimit të ngushtë ose partishmëria e tepruar, përkthehet si një farë diktature në ligj, sepse zhduket vullneti i lirë dhe personi vendoset në një pozitë të tillë që mund të veprojë vetëm me mjete shtrënguese.

“Në këtë mënyrë, po të ndjekë vetëm përligjjen legale procedurale e drejta kthehet në një farë monologu dhe jo në një dialog të shumëfishtë, siç duhej të ishte në demokraci.” (Habermas, 2002:232) Që e drejta pozitive të konsiderohet legjitime, sipas Habermasit nuk mjafton që ajo të jetë vendosur mbi bazë të rregullt procedurale, por të gjykohet e matet nga jashtë duke pyetur qytetarët për të. Kësisoj, për të e drejta është legale, legjitime në atë masë se si i gjykojnë qytetarët ligjet.

Për t’i shpëtuar akuzave për spekulime metafizike, gjë që ka qenë një kritikë e përhershme ndaj përfaqësuesve të Teorisë Kritike në të cilën përfshihet Habermasi, ai nuk përdor më konceptet *ide* dhe e *vërtetë reale* por *vlefshmëri* dhe *fakticitet*. Këto nuk janë identike me konceptet e lartpërmendura, por kanë një theks më realist përderisa, një rregull buron nga realiteti dhe bëhet për t’u zbatuar në të. Ndërsa, shtrirja ndërmjet faktit të jashtëm ligjor dhe pretendimit të brendshëm për vlerën e drejtësisë është shtrirja ndërmjet *legalitetit* dhe *përligjjes* së tij.

Duke qenë se kjo shtrirje mund të vihet në pikëpyetje e të kritikohet nga qytetari në demokraci, për Habermasin, sa më e gjerë të jetë gama e racionaliteteve dhe interesave të arsyeshme që përfshihen në ligj aq më i përligjur është ai. Nevoja për përligje përballë atyre që do t’i zbatojnë ligjet lind nga fakti se: “Sistemi i së drejtës është vendi ku integrohen mirëfilli interesat e këtyre njerëzve, prandaj ata duhet t’i gjejnë këtë interesa aty” (Habermas, 2002:50). Në këtë mënyrë përmbushet edhe ai parim demokratik, që ata që do zbatojnë ligjin të ndjehen edhe autorë të tij. Por që këto qytetarë të gjejnë dhe të ndikojnë në të drejtën pozitive, duhet që ata të kenë edhe një autonomi private krahas asaj kolektive që u garanton ligji. Pra, vetë forma demokratike e shtetit tenton ta çlirojë të drejtën pozitive prej kushteve metafizike.

Mënyra e përligjjes legale bart në vetvete edhe disa mangësi të tjera. Konkretisht, kjo mënyrë pengon herë-herë nevojën për ndryshim në shoqërinë moderne, sepse pengon ndryshimet materiale imanente të ligjit. Domethënë, sado e përgjithshme të jetë gjuha ligjore, ajo nuk e zgjidh problemin e përligjjes, sipas Habermasit, i cili këmbëngul që vetëm përvoja e funksionimit të ligjeve në demokraci, me anën e diskutimit të mendimeve dhe formimit të vullneteve, përbën një parakusht që ligjet të jenë legjitime. Për më tepër që, racionaliteti formal i përligjjes është vetëm një formë e racionalitetit. Pra, vetëm forma dhe perfeksioni teknik i bashkërendimit të ligjit nuk mund të shërbejnë si përligje për të. Përpjekja e Habermasit është që ta bëjë çështjen e përligjjes të së drejtës një çështje të organizimit dhe të përvojës, duke vendosur mjaft pikëpyetje mbi mendimin procedural.

3. Rivlerësimi i përligjjes morale

Po t'i rendisnim për nga rëndësia e tyre, përligjja morale e së drejtës, sipas Habermasit, është e para. Pas kësaj vjen përligjja formale legale. Dihet se, e drejta natyrore si një kriter përmbajtësor ka shërbyer e shërben si një formë organizuese bazë institucionale për formësimin e të drejtës pozitive. Vështirësia e zbatimit të saj sot vjen nga shumëllojshmëria e moraleve që ofrohen si përligjje në këtë drejtim. Kjo shpie në një relativim jo vetëm të moralit, por edhe të së drejtës. Edhe në këtë drejtim përpjekja e Habermasit është origjinale. Ai vërtetë që pranon orientimin përmbajtësor në moral të së drejtës, por përjashton nga ky përcaktim moral të gjitha llojet e moralit metafizik e të pandryshueshëm, duke e zëvendësuar këtë me një përligjje morale në përvojë e veprim të njerëzve. Pra, kur flitet për arsye morale këtu nuk kemi të bëjmë me një arsye të ngurtë puritane, apo një moral të krishterë, por një arsye e njerëzve në veprimin e tyre të përbashkët. Kush apelon për një arsye universale morale, si Dvorkin, është i humbur sipas Habermasit.

Po si mund të përmbushet një përligjje e tillë për x ligj ose y paketë ligjore për Habermasin: Në brendësi të së drejtës pozitive përherë gjendet e formulohet një pikë gjykimi dhe vullneti moral që nuk është e njëanshme” (Habermas, 2002: 594). Edhe këtu partishmëria e tepruar përkehet si një farë diktature në ligj dhe nuk shihet si një trajtë e përligjjes demokratike të tij. Gjykohet se është bërë mjaftueshëm për të realizuar këtë kërkesë, në qoftë se parime të caktuara morale dhe të së drejtës së arsyeshme bëhen pozitive, duke u materializuar në të drejtën kushtetuese.” (Habermas, 2002:594) Kjo nuk do të thotë se duhet të vendosim moralin përmbi të drejtën, në kuptimin e një hierarchie normash. Morali i pavarur dhe bazat e një të drejte pozitive, qëndrojnë më tepër në një marrëdhënie përplotësuese. Ndërsa, për të arritur në përligjje morale sa më të shtrirë ndikon përvoja e diskutimit demokratik të së drejtës.

4. Përligjja nëpërmjet njohjes së ndërsjellë të të drejtave

Që në shekullin e 19 të drejtat bazohen në njohjen e ndërsjellë të tyre ndër persona të lirë e të barabartë. Domethënë, personat jo vetëm kanë një sferë në të cilën ata të veprojnë sipas përfytyrimeve të tyre, siç mendonte Savigny, por ata pranojnë njëri-tjetrin si persona të lirë dhe të barabartë. E drejta civile për shembull, ishte një sistem të drejtash subjektive private për mbrojtjen e lirisë dhe të pronës, kështu edhe të vetë personit që ishte bartës i këtyre të drejtave, sepse ajo bënte një rregullim të bashkëjetesës shoqërore me anën e njohjes së ndërsjellë të të drejtave private subjektive.

Qëllimi i të drejtës subjektive ishte të bënte të mundur një sjellje zakonore të lirë prej sundimtarëve të ndryshëm. Pra forca përligjëse e kësaj të drejte private subjektive ishte një farë lirie veprimi brenda grupit. Vërtetë që, e drejta private pozitive e ruan aftësinë për vendimmarrje e për shpalosje të qytetarëve, megjithëse nuk mund të marrë parasysh

më vullnetin e veçantë të çdo njeriu. Kur drejta pozitive e humbet këtë bazë ideale zakonore, që është paraqitur mjaft mirë edhe në teorinë morale të Kantit, zhduket edhe vullneti i lirë“ (Habermas, 2002:113). Me këtë Habermasi nënkupton se pa njëfarë vullneti të lirë që i garantonte dikur e drejta natyrore, personi vendoset në të drejtën private në një pozitë të tillë që mund të veprojë vetëm me mjete shtrënguese dhe jo si një njohës i ndërsjellë i tjetrit si një person i lirë. Prandaj Habermasi këmbëngul në një formë tjetër të përligjjes si ndihmëse, atë diskursive.

5. Përligjja diskursive

Përligjja e normave ligjore ashtu si dhe atyre të së drejtës duhet të bëhet sipas Habermasit, mbi bazën e parimeve të diskutimit. Të vlefshme mund të quhen ato norma në diskutimin racional të të cilave kanë marrë pjesë mundësisht të gjithë ata që do t'i zbatojnë ato” (Habermas, 2002:138). Megjithëse mund të duket e pamundur për t'u realizuar një kusht i tillë, parimi i diskutimit, kërkon një shtrirje sa më të gjerë të kësaj ideje. Parimi i diskutimit mbështet në bashkërendimin e autonomisë private me atë kolektive. Diskutimi që ka parasysh Habermasi është praktik dhe do t'i përgjigjej më tepër pyetjes: Cilat norma do të ishin të pranueshme për ato që zbatojnë ligjet, pra për qytetarët. Ky diskutim do të synonte që: Çdo njeri të ketë një të drejtë ligjore, që të jetë në përputhje me një masë sa më të madhe lirie e veprimi subjektiv.” (Po aty, 2002:157) Për Habermasin ashtu si dhe për Rawls-in nuk mund të ketë një kufizim të kësaj të drejte, pavarësisht se sa mund ta perceptojë njeriu atë. E meqë ky diskutim bëhet për një shoqëri konkrete, ai duhet të rregullojë edhe të drejta të tjera që i përkasin një grupi shoqëror. Më së fundi ky diskutim duhet të japë garanci, që kur një person të ndjehet i cënuar në të drejtat e tij të ngrejë zërin për t'i vendosur ato në vend.

Mbi këto parime Habermasi vjen në përfundimin se e drejta për liri veprimi të barabartë duhet të shoqërohet edhe me rrugët për t'i garantuar ato, vetëm kështu mund të legjitimohet e drejta e synuar. Megjithatë edhe në demokracitë reale ky diskutim nuk sjell automatikisht liri më të madhe veprimi për masën më të madhe të njerëzve. Këto të drejta horizontale kanë nevojë të plotësohen me të drejta vertikale, domethënë, me të drejta bazë, që formalisht mund të ekzistojnë në kushtetutë, por që praktikisht nuk përmbushen. Duke e shquar si tepër të rëndësishëm këtë element Habermasi kërkon që të drejtat në fjalë të shoqërohen patjetër me të drejtat që garantojnë shanse të barabarta për pjesëmarrje në procesin e formimit të opinionëve, mendimeve e vullneteve ku qytetarët ushtrojnë autonominë e tyre dhe kështu e bëjnë legjitime të drejtën.

Të drejtat e pjesëmarrjes në demokraci u japin qytetarëve një status aktiv dhe prandaj ky diskutim është i mundur. Megjithëse ka një farë pengese në mënyrë se si funksionon struktura publike, demokracia lejon krahas shfaqjes së politikave të kabinetit edhe një kritikë të atyre që e zbatojnë ligjin, brenda ose jashtë opozitës politike. Shtresat

intelektuale që vendosen në rol joformal dialogu me parlamentin dhe administratën e që flasin në media, formojnë një element të tillë rregullativ diskutues. Megjithëse, duket sikur në demokracinë e mediave qytetarët mbeten pasiv e vetëm konsumatorë të politikës mediatike të tipit, “mos kthe përgjigje”, publiku kundërshton me anën e mjaft njerëzve që vihen e janë në pozitën e tij dhe arsyetojnë nisur nga këto interesa të tij. Këto nuk janë partitë për Habermasin, të cilat kalojnë siç po e shohim në duart e një pakice dhe më tepër i shërbejnë interesave të ngushta të tyre, se atyre të publikut, por janë një lloj *amicus curiae* ku përfshihen që nga ekspertët ligjor jashtë institucioneve shtetërore e deri të përfaqësuesit e ndryshëm të grupeve të interesit. Nëpërmjet tyre mund të mënjanohet nga ligji njëanshmëria e interesave që mund t’i japin atij partitë ose ligjvënësit. Kjo sepse, elitat janë të afta të përgjithësojnë interesat e veçanta të publikut duke i afruar ato me ligjin ose duke e kritikuar atë. Krahas elitave, të cilat mund të artikulojnë edhe interesat e grupeve të tjera dhe mund të luajnë rolin e përfaqësimit të tyre, një vëmendje të madhe Habermasi i jep mendimit publik si produkt i institucioneve prezent, institucione që janë të afta për veprim politik, si shoqata profesionale, klube, e mënyra të tjera organizimi joshtetëror.

Diskutimi që për ligj të drejtat duhet të kalojë sipas Habermasit nëpër tre parakushte, që të vlerësohet frytdhënës: Pjesëmarrja e barabartë e të gjithë atyre që ngrenë pretendime dhe argumente, sinqeriteti, që është një vlerë e provueshme nga përvoja ndaj një institucioni apo njeriu, mungesa e shtrëngimeve të tjera për të marrë një qëndrim të caktuar përveç bindjes dhe argumentit më të mirë. Këto rregulla vlejnë për të përcaktuar nëpërmjet diskutimit nëse një ligj apo grup ligjesh mund të konsiderohen të drejta apo jo. Këto parakushte, megjithëse mund të pretendohet se dihen nga formuluesit e së drejtës ligjore, duhen përmendur e vënë në dukje sa herë që i hyjmë një diskutimi për të drejtat. Ndërsa, ideologjia e sundimit dhe imponimit të arsytimit në diskutimin e së drejtës i heq çdo për ligjje normave ligjore në shtetin demokratik. Këto duhet t’i ketë parasysh ligjvënësi si parime orientuese, për sa kohë që është një ndër mediumet kryesorë të së drejtës.

Për ligjjes formale që katandisej në një farë monologu në të drejtën, Habermasi i kundërvë dialogun e lidhur me kontekstin socio-historik dhe me kontekstin individualo-psikologjik të së drejtës. Për Habermasin çdo për ligjje metafizike, ku ana formale shihet si një tabu deri diku hyjnore, është e mangët dhe duhet t’i lejë vendin një për ligjje imanente konkrete që vjen nga trualli ku zbatohet normat. Natyrisht që rruga e vendimit nga sipër mund të përdoret në rastet e vendimmarrjes pas diskutimit, por kur për ligjjet e procedohet vetëm duke marrë vendime nga lart, pa marrë parasysh atë çka thonë grupet më të përimita të interesit, atëherë kjo bie ndesh me parimin bazë të shtetit ligjor demokratik, me vullnetin e përgjithshëm i cili mbetet pa u dëgjuar. Diktati i ligjit i pashoqëruar me bindjen për të, zhduk autonominë aq të rëndësishme të individit për të përcaktuar se çfarë është e drejtë për interesat e tij. Kurse, në një proces konsensual të miratimit të normave,

autonomia e pjesëmarrësve mbetet e pacënuar dhe norma fiton përlijjen e të gjitha palëve të interesuara.

Me pak fjalë, ajo çka do që të kthejë në skenën e së drejtës Habermasi, duke e quajtur si parimin më të rëndësishëm udhëzues që i jep formën demokratike shtetit të së drejtës është *diskutimi në vend të vendimeve të njëanshme e jopërfaqësuese*. Mund të ndodhë, që kjo situatë e paraqitur prej tij të duket si utopi, sidomos kur në shtetin e partive argumenti që fiton nuk është ai më gjithëpërfshirësi i interesave, prejse ky i fundit varroset shpesh prej interesave të ngushta. Ky është një proces i tërë demokratik në kërkim të rrugëve e mekanizmave se si mund të mënjanohet diçka e tillë, dhe idetë vijnë si nga teoricienët edhe nga ata që mund të punojnë në rrafshin empirik të së drejtës.

Natyrisht që konsensusi që kërkon Habermasi ka një bazë të qenësishme, ontologjike, ndërsa ideja e diskutimit të lirë prej sundimit në çështjet e së drejtës është më tepër një ide rregullative sesa një realitet sidomos në vendet me demokraci të pakonsoliduar. Po cili mund të jetë argumenti më i mirë në një diskutim për të drejtat? Habermasi thotë se vërtet që nuk mund të vendosen kritere të jashtme për të përcaktuar cilësinë e përlijjes në diskutim, por mund të shërbejnë e përdoren kritere të tilla imanente, aftësia bindëse sa më e shtrirë e një argumenti krahasuar me të tjerët. Duke iu rikthyer edhe njëherë asaj çka thamë në fillim se e drejta është një ndërthurja e fakticitetit me vlefshmërinë, vërtetë që drejtësia materiale varet nga procedurat, por bashkimi i tyre dhe i ligjeve me veprimin konkret dhe përvojën nuk është çështje e një grupi specialistësh, por e të gjithë atyre që e përdorin ligjin. Domethënë, në diskutimin praktik për të drejtën mundet të korrigohet jo vetëm ligji por edhe mendimi vetjak i qytetarit për të, në mënyrë që të harmonizohet ligji me përfytyrimin vetjak të tij. Mund të ndodhë, që persona e individë të veçantë ta përjetojnë si humbje dhe kufizim lirie këtë lloj harmonizimi, sepse do të donin të vepronin në mënyrë të lirë të pakufizuar, ose sepse interesat e tyre nuk bashkohen me ato të tjerëve në ligj dhe nuk mund të paraqiten si interesa të përgjithshme. Por kjo duhet të kompensohet në ligjin pozitiv me përfitime të tjera që mund të ketë ky person ose grup nga marrëveshja me ligjin. Kësisoj, ligji të zgjeron fushën e lirisë së tij në një përmasë shoqërore duke i sjell liri të tjera nga ato që kishte ose do të donte individi.

Duke qenë se theksin e diskutimeve për të drejtën Habermasi e vendos te autonomia e personit e cila nuk mund të kolektivizohet apo përfaqësohet pa kushte, individi nuk kërcënohet të përthithet nga forcat e ndryshme shoqërore, për sa kohë që ky konsensus nuk është fiktiv. Si përfundim, kriteri liberal legal i përlijjes për Habermasin po plotësohet gjithnjë e më tepër në shtetin e mirëqenies sociale me kritere të tjera që i bëjnë ligjet të jenë më afër interesave e lirive personale të individit dhe jo vetëm ligje fantazëm të shkruara që nuk i zbatojnë njerëzit.

BIBLIOGRAFI

Braun, J: *Rechtsphilosophie im 20. Jahrhundert*, Die Rückkehr der Gerechtigkeit, Verlag C.H.Beck, München 2001.

Habermas, J: *Faktizität und Geltung*, Beiträge zur Diskurstheorie des Rechts und des demokratischen Rechtsstaats, Suhrkamp Taschenbuch Verlag, Frankfurt a.Main 2002.

Kaufman/Hassemer/Neumann: *Einführung in Rechtsphilosophie und Rechtstheorie der Gegenwart*. (Hrsg), 7 Aufl., Müller Verlag, Frankfurt a. Main.

Luhman, N: *Ausdifferenzierung des Rechts*, Suhrkamp Verlag, Frankfurt a Main 1999.

Savigny, F.C.v.: *System des heutigen Römischen Rechts*, Bd.1. Berlin, 1999.

Weber, M: *Rechtssoziologie*, Hrsg. von Winckelman, Neuwid 1997.

SOME METHODS OF LEGITIMATION OF LAWS IN THE *RECHSSTAAT*: THE PARADIGM OF HABERMAS

Summary: The legitimate regulation of the common social life, within which anyone enjoys the space needed for making private decisions, is based on the recognition of rights by citizens. However, the order of legal rules is legitimized, according to Habermas, only if it does not oppose the basic moral principles of the community. Based on the concepts of rationality and consensus reached through discussion, Habermas presents several ways of justifying rights in their legal form within the democratic state. Rather than applying a metaphysical basis for legal norms, he searches for their concrete basis in human action, in the natural right, and in inter-subjectivity, as a reciprocal recognition of subjective rights.

According to Habermas, a legal norm may be considered legitimate not only when it has passed through a series of known approval procedures, but also when it has been submitted to an authentic argumentation process. The liberal paradigm counts on an economic society that is institutionalized through private law, above, above all through property rights and contractual freedom, and thus left to the spontaneous workings of the market. If, however, the legal capacity of private persons to own acquire or sell property is supposed to guarantee social justice, then everybody must enjoy equal opportunities for making effective use of equally distributed legal powers.

Since capitalist societies generally do not meet this requirement, proponents of the welfare-state paradigm argue for compensating growing inequalities in economic power, property, income and living conditions. Private law must be substantially specified and social rights must be re-introduced. It turns out the traditional debate on deregulated markets versus state regulations is too narrowly focused on private autonomy, while the internal relation between private and public autonomy drops out of the picture. On this basis, Habermas's theory may be used successfully as a theoretical scheme of the concrete circumstances of justification of determined rights, or *vice versa* in refuting certain others by offering the indispensable philosophical principles on applied jurisprudence even in our country.

Keywords: Argumentation, discussion, consensus, legitimation, moral principles.